# DËSHMI ARKIVI

**A-448987**

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | BE për dënimet e ish-krerëve të UÇK-së, thirrje për përmbajtje: Gjykata të lejohet të veprojë pa ndërhyrje - Euronews Albania |
| ADRESA | `https://euronews.al/be-per-denimet-e-ish-kreeve-te-uck-se-thirrje-per-permbajtje-gjykata-te-lejohet-te-veproje-pa-nderhyrje/` |
| BURIMI | euronews.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 16 shtator 2026, 11:46:12 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 16 shtator 2026, 11:40:13 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `546915aefc4f0e1be72b3a78a923f92237d6dd6fba16f908fd775602f16fba78` |
| TEKSTI | `d04e9527f59c68fbe9ba1c2164c1ec28e4c4031c786f641e9bf483bb1e678de4` |
| PAMJA | `2572939953156d6b4a6bd2b92fea36f489aa06b2bb29324f5bddd761e94913d0` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `8cb9addbdf1efb6fd6d8d77fa7f04d9e6bb6a017d6e9a30265d86ddddb61faf0` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `aa4643f280403755043cdd17fa8b750c8d4cc9789c755656633151c3e6ad021e` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/8cb9addbdf1efb6fd6d8d77fa7f04d9e6bb6a017d6e9a30265d86ddddb61faf0`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

KOSOVË | RAJONI

# BE për dënimet e ish-krerëve të UÇK-së, thirrje për përmbajtje: Gjykata të lejohet të veprojë pa ndërhyrje

16 Shtator 2026 | 13:40

SHPËRNDAJ ARTIKULLIN

Bashkimi Evropian u ka bërë thirrje të gjitha palëve në Kosovë dhe në rajon që të tregojnë përmbajtje pas aktgjykimit ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit.

Në një deklaratë për Radion Evropa e Lirë, zëdhënësi i BE-së, Guillaume Mercier, tha se Dhomat e Specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar duhet të lejohen ta ushtrojnë mandatin e tyre pa ndërhyrje.

“Drejtësia duhet të lejohet të ndjekë rrjedhën e saj, gjë që është veçanërisht e rëndësishme për viktimat. Autoritetet kanë përgjegjësinë të garantojnë sigurinë e të gjitha komuniteteve dhe banorëve në mbarë Kosovën”, tha Mercier.

BE-ja tha se “merr shënim” aktgjykimin e shkallës së parë dhe vlerësoi se Dhomat e Specializuara po administrojnë drejtësi përmes procedurave “të drejta, të paanshme dhe të pavarura”, të bazuara në parimin e përgjegjësisë penale individuale.

Mercier rikujtoi se personat e dënuar kanë të drejtë ta apelojnë aktgjykimin para një paneli të veçantë të gjyqtarëve të Apelit.

BE-ja ritheksoi, gjithashtu, mbështetjen e saj për Dhomat e Specializuara, duke kujtuar se ato u krijuan me vendime të Kuvendit të Kosovës më 2014 dhe 2015 dhe funksionojnë brenda sistemit juridik të Kosovës.

Sipas BE-së, puna e tyre është e rëndësishme për përgjegjësinë penale dhe drejtësinë për viktimat dhe familjet e tyre nga të gjitha komunitetet në Kosovë, si dhe për pajtimin.

“Është thelbësore të promovohet një mjedis pa frikë dhe hakmarrje dhe të mbrohen viktimat dhe dëshmitarët”, tha Mercier.

**Shiko në:**

## LAJMI I FUNDIT

13:40 **Limaj pas vendimit në Hagë: Aktgjykim i padrejtë, jo në emër të popullit të Kosovës**

13:38 **Avokati i Thaçit: I rashës kokës me grushte kur gjyqtari tha në emër të popullit të Kosovës**

13:28 **Gjendja e Unionit, pesë përfundimet kryesore nga fjalimi i Ursula von der Leyen**

13:26 **Pagat e magjistratëve, Prokuroria e Përgjithshme: Diferenca të pajustifikuara dhe jo harmonike**

13:11 **Osmani: UÇK mbetet pjesa më krenare e historisë moderne të popullit tonë, dje, sot e përjetësisht**

13:08 **Dënimi me 18 vjet burgim, avokati i Veselit: Ditë e keqe për drejtësinë ndërkombëtare, vendimin do ta dërgojmë në Apel**

TESTIM

LAJME TË SUGJERUARA

## LAJME TË SUGJERUARA

KOSOVË | RAJONI

### Limaj pas vendimit në Hagë: Aktgjykim i padrejtë, jo në emër të popullit të Kosovës

Kryetari i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj ka reaguar lidhur me dënimin e ish-krerëve të UÇK-së. Ai u shpreh se vendimi i sotëm ishte një nga...

13:40 | 16/09/2026

KOSOVË | RAJONI

### Avokati i Thaçit: I rashës kokës me grushte kur gjyqtari tha në emër të popullit të Kosovës

Avokati i Hashim Thaçit, Pierre-Richard Prosper, e ka cilësuar vendimin ndaj ish-presidentit të Kosovës si një "tallje me drejtësinë", ndërsa ka bërë të ditur se...

13:38 | 16/09/2026

KOSOVË | RAJONI

### Osmani: UÇK mbetet pjesa më krenare e historisë moderne të popullit tonë, dje, sot e përjetësisht

Ish-presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani ka reaguar lidhur me dënimin e ish-krerëve të UÇK-së nga Gjykata Speciale në Hagë. Osmani shkruan se UÇK-ja mbetet pjesa...

13:11 | 16/09/2026



Copyright © Euronews 2026

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.